

KOMUNA RAHOVEC



BULETINI MUJOR KOMUNAL

SHKURT
2021

Zyra e Kryetarit

Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n, 21000, Rahovec – Kosovës

Tel :0382004534



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA RAHOVEC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KRYETARI I KOMUNES/CHIEF OF KOMUNE/MAJOR OF CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 353 Nr. ifaq/Br.str./No.pg 200

Data/Datum/Date 19 / 04 / 2021

RAHOVEC / RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2021, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin shkurt, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

FAQE

BULETINI MUJOR KOMUNAL

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE

Për nder të 13 vjetorit të shpaljes së Pavarësisë së Kosovës, Kryetari Smajl Latifi priti në mjediset e komunës qytetarë, familjarë dëshmorësh, përfaqësues të klerit fetar e miq. Më pas, së bashku me këshillin organizues dhe drejtues të shoqatave të dala nga lufa bënë homazhe dhe vendosën buçeta lulesh në varrezat e dëshmorëve të kombit në Rahovec. Po kështu, delegacione të organizuara nga këshilli organizues bënë homazhe në të gjitha vendet ku pushojnë ata që dhanë jetën për liri.



Me rastin e shënimit të 13-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, është organizuar edhe një program festiv në Shkollën e Muzikës "Faik Sylka" në Rahovec. Këtë festë edhe më madhështore e bënë kori, orkestra e shkollës, që performuan për të pranishmit.



BULETINI MUJOR KOMUNAL

Bashkëbisedim i drejtoreshës Bjondina Kleqka, me disa nga profesorët e Shkollës së Ulët të Muzikës "Faik Sylka" në Rahovec, rrëth organizimit të aktivitetave të përbashkëta, në funksion të pasurimit të jetës kulturore në Rahovec.



Zyra për hartimin e projekteve dhe kompletimin e të gjitha dokumentacioneve të nevojshme për aplikimin e granteve në Ministrinë e Bujqësisë, është e hapur dhe gjindet në hapësirat e Drejtorisë së Bujqësisë në Rahovec.



Reshjet e vazhdueshme kanë shkaktuar sërisht vërvshime në disa pjesë të komunës sonë. Drejtori Berat Duraku bashkë me Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Afrim Dina, qëndruan në Xërxe, ku panë nga afër dëmet e shkaktuara në tokat bujqësore. Ata shprehën gatishmëri që me kapacitetet tona institucionale të ndërhijmë që të evitojmë ose minimizojmë dëmet, ndërkohë që nga institucionet qendrore do të kërkojmë kompensim për secilin dëm të mëhershëm dhe të tashëm të shkaktuar nga reshjet dhe vërvshimet.

F A Q E

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Blegtoria, sektori i cili aktualisht radhitet si me i rendeteshmi ne prodhimitarin e bujqesisë. Prodhimi shumë produkteve dhe nenprodukteve bujqesore ka bëre që ky sektor të jetë prioritet në programin e drejtorisë së bujqesisë. Për herë të parë Komuna e Rahovecit ju ka dalur ne ndihmë blegtorëve, duke ju ndërtuar stalla për lopë qumështore në mënyrë që të mitet mirëqenia dhe prodhimi në fermat e tyre. Drejtori Berat Duraku me nenkryetarin e komunës z. Fatmir Iska kanë vizituar fermerinë që ka përfituar nga ky program dhe në fermën e finalizuar panë nga afër funksionimin e saj.

Programi për zhvillimin e bujqesisë vazhdon të jetë një ndër arsyet kryesore, që ne jemi duke bërë punë e cila lidhet ngushtë me kërkeshat dhe nevojat e fermerëve të komunës së Rahovecit. Drejtori Berat Duraku ka zhvilluar një takim pune me drejtorin e Bujqesisë në Komunën e Suharekës, z. Xhevdet Gashi, me të cilin kanë folur për gjendjen e sektorit të bujqesisë dhe masat e nevojshme institucionale që duhet ndërmarrë.




F A Q E

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Përfundoj trajnimi i mësimdhënësve të komunës sonë në programin "Shkollat e shekullit 21 - Mendimi kritik, zgjidhja e problemeve, Microbit".

Mësimdhënësve ju dëshirojmë sukseset në zbatimin e projekteve në shkollat e tyre!



Mirëmbajtja higjienike dhe dezinfektiimi i hapësirave të brendshme të shkollave të komunës sonë.

Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonës dimërore.



F A Q E

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Në objektin e ri të shkollës "Liria" në Fortesë kanë rifilluar punimet.

Këto ditë po bëhet instalimi i rjetit të mymës elektrike.

Vazhdojnë punimet në izolimin e jashtëm dhe punët tjera të instalimeve të brendshme në objektin e ri të shkollës në Retijë.



F A Q E

BULETINI MUJOR KOMUNAL

PĒRFUNDIM

Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe: (shkurt 2021).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t’iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjeter përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vëtëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqen zyrtarët publik në nivel lokal.

F A Q E